



HIDROCENTRALI BOSHKOV MOST PLANI PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESUARA



Përgatitur nga : **GEING KuK** 

Prill, 2011

Përmbajtje

1	HYRJE	4
1.1	Historia	4
1.2	Qëllimet afatshkurtëra të planit	4
1.3	Vëllimi i planit	5
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	5
3	NEVOJAT PËR KONSULTIME PUBLIKE	10
3.1	Kërkesat e përgjithshme dhe rregullativat ligjore	10
3.2	Pasqyra e kërkesave dhe rregullativa ligjore e R së Maqedonisë	10
3.3	Plani për shpërngulje dhe blerje të tokës	11
3.4	Pasqyra e kërkesave dhe rregullave të BEZHR	12
3.5	Praktika më e mirë ndërkombëtare	12
4	IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESUARA	13
4.1	Identifikimi i palëve të interesuara	13
5	METODAT E KOMUNIKIMIT ME PALËT E INTERESUARA	14
5.1	Modat e komunikimit	14
6	SHPALLJA E INFORMATAVE	16
6.1	Llojet e informatave që mund të shpallen	16
6.2	Funksionet dhe përgjegjësit për zbatimin e PPPI	17
7	MEKANIZMI PËR ANKESË	18
	Aneksi 1: Pasqyra grafike e procesit të ankesave	19
	Aneksi 2: Formulari për ankesën publike për HC Boshkov Most	20
	Aneksi 3: Afatet kohore të aktiviteteve të propozuara për HC Boshkov Most	21
	Aneksi 4: Tabela- Lista e palëve të interesuara në HC Boshkov Most	21
	Aneksi 5: Tabela- Aktivitetet për përfshirjen e palëve të interesuara të shfaqura deri tani	30

Lista e shkurtesave

ELEM	Termocentralet e Maqedonisë SHA
BERZH	Banka Europiane për Rikonstruksionim dhe Zhvillim
VNMJ	Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor
VNMJSH	Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Shoqërisë
HC	HIDROCENTRALI
KEKBE	Komisioni Europian i Kombeve të Bashkuara për Europën
PJT	Përmbledhje Jo teknike
PAMJSH	Plani Aksional i Mjedisit Jetësor dhe Shoqërisë
S	Selia
EE	Efikasiteti Energjetik
BRE	Burimet e Ripërtitura të Energjisë
UE	Unioni Europian
NJVL	Njësia (dhe) e Vetëqeverisjes Lokale
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizata Joqeveritare
PN	Parku Nacional (Mavrovë)
BNJVLRP	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë
RM	Republika e Maqedonisë
PPPI	Plani për Përfshirjen e Palëve të Interesuara

1 HYRJE

1.1 Historia

Ky dokument na sqaron dhe definon **Planin për Përfshirjen e Palëve të Interesuara (PPPI)** të projektit: **“HIDROCENTRALI BOSHKOV MOST”** (në tekstin e mëtutjeshëm “Projekti”).

“Investuesi i Projektit, SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (ose Kompania “ELEM” në tekstin e mëtutjeshëm), është Kompani e pronës shtetërore që merret me prodhimin e energjisë elektrike. Është prodhuese kryesore e energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë.

Kompania, gjithashtu i zotëron dhe i menaxhon të tri minierat e qymyrit, gjithashtu ka formuar edhe kompani të ndryshme shërbyese, por dhe fabrika për pajisje, mirëmbajtje, riparime dhe transporte.

ELEMI planifikon që të ndërtojë Hidrocentral te Boshkov Most-i, duke i shfrytëzuar ujërat e Lumit Malla Reka me degët e saja.

Plani për Përfshirjen e Palëve të Interesuara¹ (PPPI) e ka për qëllim që ti informojë palët e interesuara për mënyrën që u qas ELEM-i në këtë detyrë, cilët informata do të distribuoën për publikun, se si publiku do të konsultohet në lidhje me aktivitetet e përcaktuara, si dhe palët e interesuara do të kenë mundësi ti shprehin shqetësimet dhe ankesat. PPPI e merr para sysh praktikën më të mirë ndërkombëtare në lidhje me zbardhjen e informatave dhe i përshkruan parimet e përgjithshme për përfshirjen që ELEM-i do ta miratojë, si dhe ato që do të përdoren gjatë Projektit aktual.

Plani për Përfshirjen e Palëve të Interesuara do të shqyrtohet dhe azhurohet regullisht. Nëse aktivitetet ndryshohen, ose fillojnë aktivitete të reja në lidhje me përfshirjen e palëve të interesuara, PPPI do të azhurohet. Ai do të rishikohen periodikisht gjatë implementimit të projektit dhe do të plotësohet sipas nevojës.

Qëllimet specifike afatshkurtëra të PPPI vijnë më poshtë.

1.2 Qëllimet afatshkurtëra të planit

Metodat, procedurat, politikat dhe aksionet e ndërmarra nga ELEM-i për informacion me kohë dhe konsultimin me palët e interesuaranë lidhje me ndikimet potenciale të projekteve janë lëndë kryesore të këtij dokumenti.

Palët kryesore të interesuara janë identifikuar në këtë dokument. Nëse ndonjë palë e intersuar nuk është e identifikuar, ai/a jo duhet ta kontaktojë ELEM-in dhe të kërkojë që të përfshihet në dhënien e ardhshëm të informacionit dhe komunikimit.

¹ “Pala e interesuar, grupi ose organizimi që është i interesuar ose duhet të interesohet nga pasojat ekologjike dhe/ose pasojat shoqërore të projektit/aktivitetit të propozuar. Kjo përfshin individë/grupe/organizata të cilët tregojnë interes për projektin/aktivitetin si dhe pjesëmarrjen në tavolina të rrumbullakta dhe debate, dhe/ose mund të ndikojnë në implementimin dhe/ose funksionimin e projektit.

Qëllimi i mesëm afatshkurtër i këtij plani është përshkrimi i mënyrës për të cilën Kompania do të ballafaqohet me çdo shqetësim ose ankesë në lidhje me këtë Projekt.

Ky dokument poashtu na mundëson një orar kohorë për konsultime, të cilat mund të jenë lëndë të revizionit gjatë inicimit, planifikimit dhe zbatimit të projektit. Burimet në dispozicion për zbatimin e PPPI gjithashtu përshkruhen edhe në këtë dokument.

1.3 Vëllimi i planit

Ky dokument i përfshin çështjet në vijim:

- Përshkrimin e Projektit, lokacionin e projektit dhe çështjet kryesore ekologjike dhe shoqërore;
- Konsultimet publike dhe nevojat për shpalljen e informacioneve;
- Identifikimin e palëve të interesuara dhe subjeteve tjera të interesuara;
- Pasqyrën e aktiviteteve të mëparshme të ELEM-it me palët e interesuara;
- Programin për përfshirjen e palëve të interesuara si dhe metodat për përfshirjen e burimeve; dhe
- Mekanizmin për ankesë për të gjithë ata që janë të shqetësuar se interesat e tyre në këtë projekt nuk janë trajtuar siç duhet.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

ELEM-i planifikon që ta ndërtojë Hidrocentralin Boshkov Most pranë Dibrës, në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, me kapacitet prej 70 MW. Autosdrada Shkup-Dibër-Ohër kalon pranë luginës së Lumit Malla Reka ku do të vendoset projekti.

Një pjesë e rëndësishme e projektit gjindet brenda Parkut Nacional Mavrovë. Ai është gjithashtu i përhapur në dy komuna: Mavrovë-Rostushë dhe Dibër.

Ujërat e Lumit Malla Reka do të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike, ndërsa një pjesë e tyre do të lëshohen përsëri në lumin që derdhet në Radikë, 10 km përballë rrjedhës së pellgut të ujit të liqenit të Radikës me lumin Drini i Zi.

Qëllimi është që të ndërtohet:

- Penda e cila do ta formojë akumulim (liqej);
- Ndërtim që i përfshinë të gjitha rrjedhat e baseneve të lumenjve të lumit Malla Reka;
- Kanale për kahëzim, tunel kryesor për furnizim, tubacion dhe portë uji;
- Ndërtesa e makinës me turbina; dhe
- Stacioni transformatorë dhe lidhja me rrjetin kryesor për transmetimin e energjisë elektrike.

Do të ekzistojnë edhe aktivitete të përshtatshme ndërtimore, duke përfshirë kampe të punës, si dhe menaxhim me vendin e ndodhjes. Është parashikuar që periudha e ndërtimit të zgjasë katër vite.

Penda do të ndërtohet në grykëderdhjen e Lumit Jadovska në Lumin Tresoneçka nën fshatin Tresonçë. E njëjta është e gjatë 33,8 m dhe siguron një sipërfaqe të dobishme për rezervuar prej $858 \times 103 \text{ m}^3$ që do të thotë akumulimi i ujit për disa ditë. Gjatësia e tunelit kryesorë është 8742 m dhe ka një diametër prej tri metrash.

Tuneli kalon nga ana e djathtë e lumit Malla Reka përmes malit Vranjë Krastë. Në anën e djathtë ka një strukturë për grumbullimin e ujit në lumin Rosoçka. Të gjitha strukturat për grumbullimin e ujit të lumenjëve Garaskë, Vallovnice, Llazarpollskë, Svonçicë, Beleshnicë dhe kanalet për furnizim (gjatësia e përgjithshme 11.266 m) gjinden nga ana e majtë e Malla Rekës nëpër dy sifon tunele (Garë dhe Tresonçë), dhe bashkohen në tunelin kryesorë për furnizim.

Tuneli kryesor për furnizim i lëshon ujërat në portën e ujit me një profil rrethorë. Uji nga porta e ujit udhëhiqet përmes dy tubave të çelikut deri te gjeneratorët në elektranë.

Skema është projektuar që të ketë fuqi minimale të ujit prej 365 m dhe rrjedha maksimale të turbinës prej $22 \text{ m}^3/\text{s}$. Prodhimi i pritur mesatar vjetor i energjisë elektrike është 126 Gigavat në orë. Kjo sasi do të bartet në rrjetin elektrik me 110 KVA. Ende nuk është përcaktuar drejtimi në të cilin kjo lidhje do të realizohet në rrjet, ELEM-i dhe MEPSO janë në negociata (kompani nacionale e rrjetit elektrik) në lidhje me të. Mund të jetë i nevojshëm edhe një raport i veçantë në lidhje me rrjetin.

Është paraparë që periudha e ndërtimit të zgjasë 4 vite, duke filluar në fillim të vitit 2012 deri në fillim të vitit 2016. Për afatin kohor vazhdues të aktiviteteve për HC Boshkov Most, vëreni tabelën në Aneksin 3.



Figura 2-1 Harta e lokacioneve të portave të ujit



National park "Mavrovo"




Figura 2-3 Kufijt e Parkut Nacional Mavrovë dhe lokacioni i elementeve kryesore të HC Boshkov Most-it

3 NEVOJAT PËR KONSULTIME PUBLIKE

3.1 Kërkesat e përgjithshme dhe rregullativat ligjore

Konsultimet publike dhe shpallja e informatave, që do t'i bëjë ELEM-i, do të jenë në pajtueshmëri me kushtet e rregullativës ligjore të Republikës së Maqedonisë dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare, siç ishte përshkruar në kërkesat e Bankës Europiane për zhvillim dhe Rikonstruksion (BEZHR).

Udhëzimet e posaçme nga BEZHR-i për përgatitjen e këtij PPPI përfshijnë:

- Politikën për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe politikën sociale të BEZHR-it (2008),
- Politikën për informimin e publikut të BEZHR (2008),
- Nevojat për efikasitet 10; Zbardhja e informatave dhe Përfshirja e palëve të interesuara (2008).

Dokumente tjera relevante që shfrytëzohen në këtë projekte, të financuara nga BEZHR-i përfshijnë: Konventën për qasje te informacionet e KEKBE, Pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe qasjen e drejtësisë në çështjet për mjedisin jetësor (Konventa e Arhusit),

- Direktiva e UE-së 85/337/EEC e plotësuar me Direktivën 97/11/EC lidhur me Vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor nga projekte e caktuara publike dhe private.

Rregullativa ligjore e Republikës së Maqedonisë, e cila duhet të ndiqet në përgatitjen e këtij PPPI përfshinë:

- Konventën për qasje të informatave, Pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe qasjen te drejtësia për çështjet e mjedisit jetësor (Konventa e Arhusit), (Gazeta Zyrtare e RM n. 40/99), Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Urban (Gazeta Zyrtare e RM nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10 dhe 18/11),
- Ligji i mjedisit jetësor (Gazeta Zyrtare e RM n. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, dhe 124/10 dhe rregulla të ngjashme të shkallës së dytë.

3.2 Pasqyra e kërkesave dhe rregullativa ligjore e R së Maqedonisë

Ligji i mjedisit jetësor i R. Së Maqedonisë (neni 77) kategorikisht kërkon kryerjen e vlerësimit të ndikimeve të mundshme ndaj mjedisit jetësor nga projekte të posaçme publike dhe private, të cilat konsiderueshëm mund të ndikojnë në rrethinë para se të jepet leja e ndërtimit në formë të miratimit për zbatimin e projektit. Hidrocentrali “Boshkov Most” bën pjesë në atë grup të ndikimeve të theksuara në Aneksin 1, pika 12 (Projekte hidroteknike) nga “Dekreti që i cakton projektet dhe kriteret, sipas të cilave është bërë kërkesa për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor” (Gazeta zyrtare e RM n.74/05). Përfshirja e publikut në procesin e vendimmarrjes duhet të zbatohet përmes:

- a) Shpalljes së informatave në Publik,
- b) Pjesëmarrjes së publikut - Publiku duhet aktivisht të përfshihet në diskutime të hapura publike, si dhe në parashtrimin e pyetjeve dhe mendimeve me shkrim në kuadër të fazave të ndryshme nga procedura e VNMD,
- c) Mekanizmi për çasje të drejtësia- Publiku mund të ndikojë në vendim përmes dorëzimit të ankesave Gjyqit ose Komisionit të shkallës së dytë të Qeverisë.

Pas përfundimit të studimit për VNMD, Investuesi është i obliguar të njejtin t'ia dorëzojë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH), e cila patjetër duhet që në afat prej 5 ditësh ta shpallë në versionin digjital në web- faqen e saj, dhe ta dorëzojë për konsultim në komunën në të cilën do të realizohet projekti. Procesi i paraqitjes publike dhe i komentimit zgjat 30 ditë, duke filluar nga dita e shpalljes publike të saj. Komentet dhe mendimet lidhur me studimin duhet të dorëzohen në formë të shkruar deri te Trupi qeveritar përgjegjës (MMJPH), dhe këtë mund ta bëjë çdokush. Nëse ndonjë studim për VNMD nuk i plotëson kërkesat e Nenit 84 të Ligjit për Mjedisin Jetësor të R. së Maqedonisë, ai do ti kthehet investitorit për kontroll që nuk guxon të zgjasë më shumë se 40 ditë, duke llogaritur nga data e pranimit të studimit (Ligji i Mjedisit Jetësor i R. Së Maqedonisë: Neni 83).

MMJPH duhet të organizojë debat publik (Ligji i Mjedisit Jetësor në R. e Maqedonisë: Neni 91) më së paku 5 ditë para përgatitjes së Raportit për përshtatshmërinë e studimit të VNMD, për të cilin është paraparë një periudh brenda 60 ditëve nga momenti i dorëzimit të studimit deri te MMJPH.

3.3 Plani për shpërngulje dhe blerje të tokës

Elementet e caktuara të Projektit duhet të ndërtohen në tokën që është pronë private. Në rast të ndonjë humbje të përhershme të kullotave dhe tokës pjellore, pyjeve ose pronave tjera, si dhe dëmit të mundshëm gjatë fazës së ndërtimit ose gjatë punës dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, bëhet kompensimi i dëmit në mënyrë korrekte dhe me procedura transparente, në pajtueshmëri me rregullativën ligjore të R. së Maqedonisë dhe Politikën për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe politikën sociale të BEZHR [2008] (Nevojat për efikasitet 5).

Projekti do të ndërtohet në zonat me një dendësi të vogël të popullatës, por mund që të preken një numër i ndërtesave për banim në sferën e paraparë për akumulim, në Tresonçë. Kuadri për fitmin dhe kompenzimin e tokës tashmë është përgatitur për informim publik, ndërsa Plani më i detajuar për fitimin e tokës dhe kompenzimin do të krijohet për një kohë të caktuar dhe në konsultim të ngushtë me pronarët e prekur potencialisht dhe shfrytëzuesit e pronës, me qëllim që të qetësohen ndikimet negative të procesit

3.4 Pasqyra e kërkesave dhe rregullave të BEZHR

BRZHR konsideron se konsultimi dhe përfshirja e palëve të interesuara paraqet një proces të pandërprerë, i cili duhet të fillojë në fazën më të hershme të procesit të vlerësimit të mjedisit jetësor dhe vazhdon gjatë tërë ciklit të projektit financiar nga BEZHR.

Vemendje e veçantë duhet kushtuar identifikimit të palëve të prekurara të lënduara, të cilat mund të jenë të prekura disproporcionalisht nga aktivitetet projektuese. Konsultimi dhe komunikimi me këto grupe të lënduara të palëve të prekura duhet të planifikohet dhe menaxhohet me kujdes të veçantë.

Gjithashtu, BEZHR kërkon nga hartuesi i projektit (ELEM-i) të vendosë dhe mbajë mekanizëm efektiv të ankesave, i cili do të sigurojë se të gjitha ankesat dhe pyetjet deri te pala e intersuar janë pranuar, shqyrtuar dhe zgjidhur në mënyrë efektive, shpejt dhe me kohë.

3.5 Praktika më e mirë ndërkombëtare

Parimet kryesore për punën efektive janë sumuar më posht:

- Sigurimi i informacionit të rëndësishëm në një format dhe gjuhë që kuptohet lehtë dhe përshtatet për nevojat e grupeve të synuara të palëve të interesuara;
- Sigurimi i informacionit para kohe në lidhje me aktivitetet konsultuese dhe vendimarrje;
- Sigurimi i informacionit në mënyrë dhe lokacione që do t'ju mundësojë palëve të interesuara qasje më të lehtë për to, dhe që janë të përshtatshëm në aspektin kulturorë;
- Respektimin e traditave lokale, gjuhëve, kuadrove kohore dhe proceseve të marrje së vendimeve;
- Dialog dy drejtimesh që ju jep mundësi për shkëmbimin e mendimeve dhe informtave të të dy palëve si dhe mundësi për dëgjimin dhe referimin e problemeve;
- Përfaqësimi i grupeve të ndryshme, duke përfshirë mosha të ndryshme, meshkuj dhe femra, grupe të cënueshme dhe/ose minoritare;
- Punë pa kërcnim, detyrim ose blerje;
- Mekanizma të qartë për përgjigjen e pyetjeve, propozimeve, ankesave të njerëzve; dhe
- Kur është e mundur dhe e qëndrueshme, më e dëshirueshme është përfshirja e informatave retroaktive në përgatitjen e projektit ose programit dhe lajmërimi i sërishëm i palëve të interesuara.

4 IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESUARA

4.1 Identifikimi i palëve të interesuara

Kjo pjesë e dokumentit i identifikon palët e interesuara që d.m.th . palët e interesuara, si dhe të tjerat të cilat janë të interesuara për nivelin lokal, rajonal dhe nacional.

Palë të interesuara, gjithashtu mund të jenë individët dhe organizatat, të cilët kanë mundësi të intersohen nga projekti në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe tërthorazi, pavarësisht nëse intersohen në mënyrë pozitive ose negative, si dhe ato që dëshirojnë ti shprehin pikëpamjet e tyre.

ELEM-i ndërmerr inicijativa për ti identifikuar palët e interesuara kryesore të këtij Projekti. Në këtë janë përdorur definicionet e mëposhtme:

Palët e interesuara mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- **Palët primare të interesuara:** secila palë e interesuar që ka ndikim të rëndësishëm të aktiviteteve, ndërsa prej aktiviteteve, ku këto interesa dhe ndikime duhet të pranohen nëse aktiviteti është i suksesshëm; dhe
- **Palët sekundare të interesuara:** çdo person, grup ose organizatë me interes personal nga rezultatet e aktivitetit.

Ekzistojnë partneritete dhe marrëveshje formale këshilluese, si dhe marrëveshje më pak formale, por të rëndësishme me grupet ose individët që kanë interes të veçantë në aktivitetin që do ta ndërmerr ELEM-i.

Palët e interesuara mund të grupohen në kategoritë në vijim:

Palët primare të interesuara:

- Investuesit
- Institucionet qeveritare
- Vetëqeverisja lokale
- Agjencionet qeveritare dhe Institucionet shkencore
- Banorë që janë drejtëpërdrejt të interesuar/ pronar të pronësisë dhe organizatat e njeta të bazuara në bashkësinë
- Të punësuarit dhe kontraktuesit

Palët sekundare të interesuara:

- Organizatat qytetare

- Sektori privat/ Biznes asociet
- Institucionet religjioze
- Banorë që janë tërthorazi të interesuar / pronarë të pronave
- Mediat
- Publiku i përgjithshëm

Më shumë informata në lidhje me të gjitha palët e interesuara identifikuese të projektit HC Boshkov Most mund të gjinden në Listën e palëve të interesuara, të theksuara në **Aneksin 3** të këtij dokumenti.

5 METODAT E KOMUNIKIMIT ME PALËT E INTERESUARA

5.1 Modat e komunikimit

ELEM-i do ti promovojë, vendosë dhe shfrytëzojë të gjitha metodat efikase të komunikimit me qëllim që ti arrij deri te palët e interesuara dhe të vendosë një dialogë të hapur që do të ndihmojë në tejkalimin e çështjeve kritike në lidhje me realizimin komplet të Projektit.

Një spektër i gjerë i metodave të komunikimit do të përdoret nga palët e ndryshme të interesuara. Ai përfshin:

- Takime publike;
- Takime individuale;
- Kumtesa nëpër mediat lokale dhe nacionale;
- Sigurimin e informatave të përgjithshme nëpër tabelat e shpalljeve të vendosura nëpër vendet publike kryesore;
- Korenspondencën e rregullt përmes postës/ e-mail;
- Shpalljen e informatave për projektet relevante në veb-faqen e kompanisë www.elem.com.mk;

Tabela-Metodat e komunikimit që janë zhvilluar dhe shfrytëzuar me palët e interesuara të caktuara

Palët interesuara		Metodat e komunikimit
Palët e interesuara kryesore	Investuesi	• Komunikim brenda ditës i drejtpërdrejt në çdo fazë të projektit
	Institucionet qeveritare	• Korenspondencë e rregullt dhe e vazhdueshme në përputhje me procedurat administrative, dorëzimin e dokumentave të pranuar përmes postës së zakonshme (letrave zyrtare) dhe takimeve konsultative.

	Vetëqeverisja lokale	Korenspondencë e rregullt dhe e vazhdueshme në përputhje me procedurat administrative, dorëzimin e dokumentave të pranuar përmes postës së zakonshme (letrave zyrtare) dhe takimeve konsultative.
	Agjencionet qeveritare dhe Institucionet shkencore	Korenspondencë e rregullt dhe e vazhdueshme, shkëmbimi i të dhënave dhe informatave të nevojshme për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të planifikuara. Komunikim i rregullt përmes postës/e-mail, letra zyrtare dhe takime konsultative
	Të punësuarit dhe kontraktuesit	- Komunikim me të punësuarit në pajtim me rregullat dhe procedurat e komunikimit inter të ELEM-it - Komunikim me kontraktuesit në pajtim me rregullat e thekësuara në Marrëveshjen midis ELEM-it dhe secilës kompani ndërtimore
	Banorët që janë drejtpërdrejt të interesuar/ pronar të pronësisë dhe organizatat e njeta të bazuara në bashkësinë	- Banorët që ballafaqohen me ndryshimet e infrastrukturës, pengesat dhe ndërprerjet duhet që të komunikohen përmes mediave (tabelave të shpalljeve, shpalljeve në media, kumtesave publike) dhe takimeve publike konsultative - Procesi i blerjes së tokës do të bëhet personalisht me pronarët e pronësisë.
Aksionerët vartës	Organizatrat qytetare	Komunikimi përmes e-mail-it, veb-faqes, buletinëve, mediave (kumtesave publike, promovimeve), takime të drejtpërdrejta me publikun
	Sektori privat/ Biznes asocimet	Shkëmbimi i informatave, mediave, veb-faqes, buletineve
	Institucionet religjioze	Shkëmbimi i informatave
	Banorë që janë indirekt të interesuar/ pronarë të pronave	Banorët që janë të interesuar për aktivitetet e projekteve në vazhdim në rrethin e tyre duhet të komunikohen përmes mediave (tabelave të shpalljeve, shpalljeve në media, kumtesave publike), veb-faqeve dhe takimeve konsultative publike sipas nevojës.
	Mediat	Kumtesa publike, takime sipas nevojës, promovime.
	Publiku i përgjithshëm	Kumtesa publike, takime sipas nevojës, promovime.

5.2 Aktivitetet komunikuese të palëve të interesuara

Ekziston proces i vazhdueshëm i komunikimit me aksionistët. **Aneksi 5** në mënyrë të qartë i përshkruan të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e palëve të interesuara që janë zhvilluar deri tani.

5.3 Udhëheqja e shënimeve nga komunikimi me palët e interesuara

Mekanizëm formal i ankesave është zhvilluar dhe implementuar nga Kompania, që e përfshin fazën ndërtimore dhe operative të Projektit HC Boshkov Most. Mekanizimi i ankesave poashtu do të përfshihet edhe në sistemin ekologjik, shëndetësorë dhe të sigurisë që e zbaton Kompania për lokacionet. Ai do të shpallet në tabelat e shpalljeve dhe hapësirat publike në bashkësit lokale dhe nëpërmjet mediave lokale (gazetave, radiove, televizioneve).

Do të zhvillohet një procedurë për të dhënat e komunikimit, që do të regjistrojë informatat globale që dorëzohen nga palët e interesuara, si dhe komunikimi kryesor për ELEM-in i që vijon (p.sh. Pyetjet e përgjithshme, ankesat etj), së bashku me përshkrimin e shkurtër nga aksionet e ndërmarra.

Si pjesë e kësaj procedure komunikuese, ELEM-i rregullisht do të regjistrojë dhe azhurojë këto aktivitete vijuese në lidhje me përfshirjen e palëve të interesuara.

6 SHPALLJA E INFORMATAVE

6.1 Llojet e informatave që mund të shpallen

Informatat që do të shpallen llogariten si pjesë të programit gjithëpërfshirës zhvillimorë të ELEM-it për HC Boskov Most. Në veçori të përgjithëshme, komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm e kryen ELEM-i në mënyra të ndryshme të përshkruara këtu. Qëllimet e komunikimit të jashtëm janë:

- të sigurojë përfshirje të vazhdueshme për qëllimet e publikut; dhe
- të sigurojë informata për aktivitetet e Kompanisë, duke e përfshirë efikasitetin e sajë, zhvillimin, planet investuese dhe implementimin e tyre.

Informatat e përgjithshme në lidhje me çështjet e rëndësishme për të gjitha fazat të (planifikimit, ndërtimit dhe funksionimit) në lidhje me realizimin e Projektit, si broshurë dhe përshkrim i shkurtër i Projektit do të jenë në dispozicion në:

- veb faqjen e ELEM-it (www.elem.com.mk);
- tabelën e shpalljeve në hapësirat e Komunave relevante; dhe hapësirat lokale të ELEM-it.

Informata më të detajuara, duke përfshirë dokumentet relevante si p.sh:

- Përmbledhje jo-teknike (PJT) e Kumtesës për ndikimin ekologjik dhe shoqërorë;
- Plani për Përfshirjen e Palëve të Interesuara (PPPI);
- Plani Aksional i Mjedisit Jetësor dhe Shoqërisë (PAMJSH);
- Studimi për Vlerësimin e Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Shoqërisë (SVNMJSH); dhe
- Vendimet/lejet ekologjike dhe ndërtimore.

Do të jenë në dispozicion në kopje të shtypura , me kërkesë të paraprase për:

- zyrat e selisë së ELEM-it në Shkup;
- zyrat e ministrive relevante; dhe
- zyrat e Komunës së interesuar.

Verzionet elektronike të këtyre dokumenteve (RJT, PPPI dhe PAMJSH) do të jenë në dispozicion në veb-faqen e ELEM-it (www.elem.com.mk) dhe BERZH-it (www.ebrd.com).

6.2 Funkcionet dhe përgjegjësit për zbatimin e PPPI

Përfshirja e palëve të interesuara është një rëndësi thelbësore për qëllimet e ELEM-it, për realizimin e suksesshëm të Projektit Boshkov Most. Përfshirja e herëshme e palëve të interesuara dhe identifikimi i sfidave thelbësore të cilat mund të ndikojnë seriozisht në rezultatin e projektit të planifikuar mund të shërbejnë si bazë thelbësore për një bashkëpunim të shkëlqyer midis Kompanisë dhe Bashkësisë ku do të ndërtohet ky projekt.

Personi përgjegjës për zbatimin e plotë të Planit për angazhimin e palëve të interesuara është :

Goran Stoilov, Inxhinier përgjegjës për Hidro Energjinë

Sektori për Zhvillim dhe Investime

Tel: + 389 (0)2 31 49 204

Faksi: + 389 (0)2 32 24 492

e-mail: boskov.most@elem.com.mk

goran.stoilov@elem.com.mk

Adresa: **SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (ELEM)**

11 tetori 9, 1000 Shkup, Maqedoni

Një plan i detajuar për aktivitetet e mëposhtme lidhur me përfshirjen e palëve të interesuara është paraqitur në **Aneksin 6**.

7 MEKANIZMI PËR ANKESË

Të gjitha llojet e ankesave nga palët e intersuara (përveç atyre të punonjësve dhe të kontraktuesëve) në lidhje me Projektin duhet të dorëzohen deri tek personi në vazhdim i ELEM-i:

Xvonko Kushoski, Inxhinier për investime

Tel: + 389 (0)2 31 49 164

Faksi: + 389 (0)2 31 49 100

e-mail: boskov.most@elem.com.mk

zvonko.kusoski@elem.com.mk

Adresa: **SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (ELEM)**

11 tetori 9, 1000 Shkup, Maqedoni

ELEM-i do ta implementojë mekanizmin e ankesave që vijon:


- 1) Vërtetimi për pranimin e ankesës duhet të jetë në a brenda 5 ditëve pune nga dita e pranimin të ankesës.
- 2) Përgjigja duhet të kthehet brenda 30 ditëve nga dita e pranimin të ankesës.

Në **Aneksin 1** në mënyrë grafike është paraqitur pjesa e procedurës (korniza). Mënyra e dorëzimit të ankesave do të theksohet në tabelat lokale të shpalljeve dhe në veb-faqen e ELEM-it (http://www.elem.com.mk/images/photo/projects/Boskov_Most.pdf); që do të jetë në dispozicion “Formulari për ankesa ” (vërej **Aneksin 2**).

Ankesat e jashtme në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndikimin shoqëror të Projektit do të regjistrohen dhe ruhen në ditarin për ankesa.

Ankesat nga të punësuarit që përfshihen në Projektin do të ndiqen përmes përfaqësuesëve të përshtatshëm të sindikatave, dhe në qoftë se ka mundësi edhe ELEM-i mund të përfshihet drejtpërdrejt për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme. Të gjitha ankesat që rrjedhin nga kontraktuesit, duhet të dorëzohen nëpërmjet kanaleve të zakonshme përcaktuese komerciale.

Aneksi 1: Pasqyra grafike e procesit të ankesave



Aneksi 2: Formulari për ankesën publike për HC Boshkov Most

Formulari për ankesën publike	
Num. referues:	
Emri dhe mbiemri	
Informata për kontakt: Ju lutemi na specifikoni se si dëshironi që t'ju kontaktojmë (postës, telefonit, e-mail)	Përmes postës: Ju lutemi t'na shkruani adresën e postës: _____ _____ Përmes telefonit: _____ Përmes e-mail: _____ _____
Gjuha e preferuar për komunikim:	[Maqedonisht] [Shqip] [Turqisht]
Përshkrimi i ngjarjes ose ankesës: Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi ajo? Cili është rezultati i problemit? _____ _____ _____	
Data e ngjarjes/ankesës	
	Ndonjë ngjarje/ankesë e dikurshme (data _____) Ndodhi më shumë se një herë (sa herë? _____) (Problemi vijues me të cilin momentalisht ballafaqoheni)
Çka dëshironi Ju të ndodhë që të zgjidhet problemi? _____ _____ _____	
Nënshkrim: _____ Data: _____	
Ju lutemi që formularin t'ia ktheni: Xvonko Kushoski, Inxhinier për investime Tel: + 389 (0)2 31 49 164 Faksi: + 389 (0)2 31 49 100 e-mail: boskov.most@elem.com.mk Sektori për Zhvillim dhe Investime SHA TERMOCENTRALET E MAQEDONISË (ELEM) 11 tetori 9, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë	

Aneksi 3: Afatet kohore të aktiviteteve të propozuara për HC Boshkov Most

		HC BOSHKOV MOST- AKTIVITETET E PROJEKTEVE						
		Vlerësimi i Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor dhe Shoqërisë (VNMJSH)	VNMJSH konsultime publike (kërkesat në R.e Maqedonisë 30 ditë)	VNMJSH konsultime publike (kërkesat në BERZH)	Projekti përfundimtar	Ndarja e marrëveshjes	Periudha e ndërtimit në vend	Periudha operative e centralit elektrik
Orari kohor i aktiviteteve	Aktiviteti FILLON	Shku. 11	Korik 11	Korik 11	Shtat. 11	Maj.12	Korr. 12	Korr'16
	Aktiviteti PËRFUNDON	Qer 11	Korik 11	Nënt . 11	Dhje . 11	Maj. 12	Prill. 16	nuk ka info.
	Kohëzgjatja (Muaj)	5	1	4	3	4	48	nuk ka info.
Palët primare të interesuara	Investuesit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Institucionet qeveritare	✓	-	-	✓	-	✓	✓
	Vetqeverisja lokale	✓	✓	✓	✓	-	✓	✓
	Agjencitë qeveritare dhe institucionet shkencore	✓	-	-	✓	-	✓	✓
	Banorë që janë drejtëpërdrejtë të interesuar/ pronarë të pronës dhe organizata të njejta të komunave	✓	✓	✓	-	-	✓	✓
	Të punësuar dhe kontraktues	-	-	-	✓	✓	✓	✓
Palët sekundare të interesuara	Organizatat e qytetarëve	✓	✓	✓	-	-	✓	✓
	Sektori privat/ Biznes Asocimet	✓	-	-	-	-	✓	-
	Institucionet religjioze	✓	✓	✓	-	-	✓	-
	Banorë që janë të përfshirë tërthorazi/pronarë të pronës	✓	✓	✓	-	-	✓	✓
	Mediat	✓	✓	-	-	-	✓	✓
	Publiki i përgjithshëm	✓	✓	✓	-	-	✓	✓

Aneksi 4: Tabela- Lista e palëve të interesuara në HC Boshkov Most

Grupet e palëve të interesuara	Pala e interesuar	Pasqyrë e shkurtër e interesave specifike
Palët primare të interesuara		
Investuesit	ELEM 11 tetori 9 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 31 66 758 Faksi: (02) 2 31 12 165 e-mail: contact@elem.com.mk	
	BERZH Ndërtesa e Makoshpedit Maqedoni 19 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3297 800 Faksi : (02) 3231 238	E interesuar për investime të duhura dhe cilësore
Institucionet qeveritare	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor Bul. Goce Dellçev pn (RTVM, kati i 10-11-12) 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3251-400; Faksi: (02) 3220-165; email: infoeko@moepp.gov.mk	Përgjegjëse për dhënien e mendimit dhe lejen për ndërtimin e projektit të planifikuar
	Ministria e Ekonomisë Jurij Gagarin 15 1000 Shkup, Maqedoni Tel: 3093-408 Faksi: 3084-472 www.economy.gov.mk	Përgjegjëse për Sektorin e Energjisë, sektor i cili i takon këtij Projekti
	Ministria e Financave Dame Gruev 15 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3117-288 Faksi: (02) 3106-779 e-mail: finance@finance.gov.mk	Zyra e Çështje Pronësore dhe Juridke, e cila vepron në kuadër të Ministrisë është përgjegjëse për shpronësimin e tokës.
	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve Çërvena Skopska Opshtina 4 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3145-497 Faksi: (02) 3126-228 e-mail: contact@mtc.gov.mk	Përgjegjëse për planifikimin, sigurimin dhe formatimin e infrastrukturës për të mirën e njerëzve që jetojnë /pushojnë në sferën tjetër të prekur, si dhe sigurimin e informatave me rëndësi jetike.
	Ministria e Kulturës Gjuro Gjagoviq 61 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3240-600 faksi: (02) 3240-561 info@kultura.gov.mk www.kultura.gov.mk	Përgjegjëse për ruajtjen e kulturës
	Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Gjuro Gjagoviq 61 1000 Shkup, Maqedoni Tel: (02) 3289-703 Fax: (02) 3289-777 contact@uzkn.gov.mk www.uzkn.gov.mk	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore
	Agjencia e Energjetikës së	AERM e mbështet zbatimin e politikës energjetike të Qeverisë, përmes përgatitjes të

Grupet e palëve të interesuara	Pala e interesuar	Pasqyrë e shkurtër e interesave specifike
	Republikës së Maqedonisë Orce Nikollov 68 1000 Shkup, Maqedoni Tel. / Fax. 389 2 3230300 ea@ea.gov.mk www.ea.gov.mk	strategjive energjetike, planeve dhe programeve zhvillimore me theks të veçantë të efikasitetit energjetik (EE) dhe përdorimin e burimeve të ripërtitura të energjisë (BRE).
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave Juri Gagarin 15 1000 Shkup, Maqedoni Tel / Fax: (02) 3134-477 info@mzsv.gov.mk www.mzsv.gov.mk	Ministria është përgjegjëse për menaxhimin me burimet natyrore.
Agjencionet qeveritare Institucionet shkençore	Agjencioni për Kadastër të Patundshmërive Drezdenska pn Tel: 0800 80 800 Tel: (02) 3097-301 Fax: (02) 3097-336 www.katastar.gov.mk	Përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin me sistemin gjeodik-kadastral informativ, regjistrimin e të drejtave të patundshmërisë etj. Efektivitet në grumbullimin e dokumenteve të kadastrës.
	SHA MEP SO (operatori i sistemit transmetUES të Maqedonisë) Tel: (02) 3149-005 Fax: (02) 3111-160 npetreska@mepso.com.mk www.mepso.com.mk	Përgjegjëse për transfer të papenguar të energjis elektrike përmes rrjetit me tension të lartë, kontroll të sistemit të energjis elektrike, shpërndarjen e rregullt dhe në kohë të energjis elektrike për klientët e sajë, dhe rrjetit me tension të ulët të EVN-së së Maqedonisë.
	Parku Nacional Mavrovë Zyra e Projektit – Menaxhimi i, Parkut Nacional Mavrovë Mavrovi Anovi, Maqedoni Tel: (042) 489-019 Fax: (042) 489-505 www.npmavrovo.org.mk npmavrovo@npmavrovo.org.mk	Një numër i madhë i burimeve natyrore në zonën e prekur menaxhohet nga Parku Nacional Ekziston një Projekt i financuar nga Qeveria e Italisë përmes organizatës joqeveritare e cila ka për detyrë që të zhvillojë një Studim për rivalorizimin e vlerave të Parkut Nacional Mavrovë, të propozojë kufij dhe zona të reja në Park dhe të bëjë një Plan për menaxhim.
